



Npi – 01/25 datë: 27.01.2025

Duke u bazuar në nenin 17 shkronja (a) dhe (c), dhe nenin 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 4 dhe 8 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092; Nenin 6 paragrafi 3, neni 13 dhe 14 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; Planin Zhvillimor Komunal 2009-2020; Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/13 dt.24.01.2025; Propozimin e Zyrës së Kryetarit Nr.02/33 të datës 17.01.2025, Kuvendi Komunës së Shtimes, në seancën e mbajtur më 27.01.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË PRONËN KOMUNALE NË ZONËN KADASTRALE - SHTIME

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e -I- të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më 27.01.2025, me shumicën e votave miratoi Vendimin paraparak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën Komunale, si vijon:

1. Ngastra Kadastrale me numër: P-72809093-01403-0, me sipërfaqe prej: 140629m², Kultura - Kullosë e klasit të -IV- (katër). Z.K-Shtime. Pronari/Poseduesi “Komuna e Shtimes”.
2. Ngastra Kadastrale me numër: P-72809093-02295-30, me sipërfaqe prej: 81157m², Kultura – Mal i klasit të -III- (tretë). Z.K-Shtime. Pronari/Poseduesi “Komuna e Shtimes”.

II

A r s y e t i m: Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë, të pronave të paluajtshme të Komunës së Shtimes janë: Të mundësoj implementimin e Planit Zhvillimor Komunal 2009 – 2020, Përkrahjen e bizneseve vendore, Rritjen e punësimit, Rritjen e Investimeve, Rritjen e numrit të taksapaguesve, Zhvillim Ekonomik, dhe të hyra më të mëdha për Buxhetin e Komunës.

III

Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë, do të kryhet duke u bazuar në ligjet pozitive si dhe përmes konkurrencës së hapur publike.

IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi